

GREQISHTJA - NJË BIJË E SHQIPES

Agron **DALIPAJ**¹

PËRMBLEDHJE

Përqasja ndaj së vërtetës është gjithmonë me rrezikun e të panjohurës brenda. Nëse në eksperimentet kimike apo fizike një gabim mund të marri jetën e specialistit apo shkencëtarit, në lëmin e shkencës së etimologjisë gabimi e pakujdesja të nxijnë emrin për tërë jetën dhe aq më zi kur gabuesi është "emër i madh" në shkencë. Në lashtësi askush nuk dinte se nga se shkaktoheshin sëmundjet dhe pse përhapeshin ato. Por, një lente e thjeshtë e një portieri bashkie në Belgjikë (Leven Huk) i parapriu mikroskopit dhe revolucionit më të madh në mjekësi.

Fjalë kyce – greqishtja, bijë e shqipes,

HYRJE

Shumkujt, që nuk më ka ndjekur në postimet e mia, mund ti shkaktojë me të drejtë një nënqeshje mosbesimi, që rrjedh nga vetkontrolli që ka çdo njeri, për të pranuar ose jo një ide të re e aq më shumë kur ajo duket aq radikale. Si mund të jetë greqishtja, kjo gjuhë e ndritur e qytetërimit europian, bijë e një gjuhe tjetër që zyrtarisht u bë me alfabet vetëm 111 vite më parë!? Ndër kaq, nuk e kemi zor të pranojmë se kostumi elegant i presidentit të USA mund të jetë stiluar nga një emigrant moldav. Paralelja logjike duket absurde. Po të isha i pari njeri, që e thosha se greqishtja është bijë e shqipes, do ti justifikoja të gjithë ata që do më kategorizonin si të shkalamendur. Porse e kam më se seriozisht se shqipja ka stilizuar që në krye të herës greqishten dhe jo vetëm atë. Gjithë glosologët europianë, e më tej, kanë pranuar pa mdyshe hegjemoninë e gjuhës greke mbi gjithë gjuhët europiane e më gjerë. Kaq e aq koncepte gjuhësore greke përdoren në shkallë botërore në mjekësi, fizikë, kimi, filozofi e në shumë shkenca të tjera. Përqasja ndaj së vërtetës është gjithmonë me rrezikun e të panjohurës brenda. Nëse në eksperimentet kimike apo fizike një gabim mund të marri jetën e specialistit apo shkencëtarit, në lëmin e shkencës së etimologjisë gabimi e pakujdesja të nxijnë emrin për tërë jetën dhe aq më zi kur gabuesi është "emër i madh" në shkencë. Në lashtësi askush nuk dinte se nga se shkaktoheshin sëmundjet dhe pse përhapeshin ato. Por një lente e thjeshtë e një portieri bashkie në Belgjikë (Leven Huk) i parapriu mikroskopit dhe revolucionit më të madh në mjekësi.

1. GREQISHTJA - NJË BIJË E SHQIPES

Nëse mikroskopi i lejoi njerut të njohë botën e madhe e të panjohur të mikrogjallesave, prej të cilave varet në masën më të madhe cikli i jetës në tokë, por ai, njeriu modern, nuk ka qenë në gjendje deri sot të zbërthejë fjalën e të kuptojë se si është krijuar ajo. Dhe bëhet fjalë fiks për këtë njeri që bëri mrekullinë duke zbërthyer atomin. Më afër së vërtetës janë afruar "etimologët popullorë shqiptarë", por fakti se ata nuk mbështeten mbi parime të sakta shkencore duke i

¹ *Studius i gjuhësisë, Kumtesë etimologjike për greqishten sipas teorisë së embriomorfemave*

mëshuar fort empirizmit dhe gjetjeve dukshëm të thjeshta, ngecen në baltovinën e padijes për zbërthimin e korpusit më të madh të leksikut dhe herë herë bëhen qesharkë me "zgjidhjet" e tyre që nuk janë zgjidhje. Aq shumë ngjajnë ata me xherahët e epokës së Perandorisë Turke. "Lentja e suksesit" në etimologji është teoria shkencore e embriomorfeve e cila nëpërmjet parimeve e rregullave të përcaktuara qartë arrin ta zbërthejë fjalën në kuptimet më të vogla të mundshme dhe të precizojë se çdo bashkëtingëllore brenda një fjale përfaqëson një kuptim potencial real dhe e përkufizon fjalën si bashkësi embriomorfemash që kapen mes tyre për të krijuar një koncept gjuhësor që rëndom e quajmë fjalë.

Ende sot jemi në kërkim për të gjetur një institucion zyrtar shkencor për të afirmuar këtë teori të re me të cilën synojmë të sjellim revolucionin më të madh në gjuhësinë botërore. Porse kërkesës sonë ASH-ja e Tiranës iu përgjigj se "akademikët e saj nuk kanë kohë të përshtatshme për tu marrë me këtë teori". Gjithsesi, ata e kanë kuptuar se kjo teori nxjerr fallco krejt morfologjinë e sotme zyrtare të gjuhës shqipe dhe të të gjitha gjuhëve i.e. dhe në vend të saj zë vend tabela e embriomorfemave e cila nuk ka më shumë se sa 400 elementë gjuhësorë kuptimorë dhe të cilët kanë formuar gjithë leksikun e gjuhëve i.e. dhe janë në gjendje të zbërthejnë cdo fjalë duke na lejuar të kuptojmë etimologjinë e saktë të tyre. E rëndësishme është të theksojmë se këto embriomorfe, që përbëjnë tabelën e plotë të tyre, gjenden të gjitha të lira vetëm në gjuhën shqipe dhe në asnjë tjetër. Mjafton të theksojmë se greqishtja ka vetëm 11 embriomorfe të lira që sillen si plagjiatura të shqipes dhe me aq pak e ka të pamundur të mbërthejë koncepte, fjalë. E njëjta gjendje, si në greqisht, është edhe në gjuhët e tjera. Kjo teori, me tabelën e saj të embriomorfeve, sjell shqipen si qendër e gjuhëve i.e. në mënyrën më të pakundërshtueshme shkencërisht. Nëse ASH-ja e Tiranës nuk do ishte një institucion gjytyrmësh, që vetëm sa mëtojnë përrallat sllave, me kohë gjërat do kishin përparuar.

Historia e mendimit, se greqishtja është pjellë e shqipes, duket se fillon me rilindasit tanë të mëdhenj, vazhdon me Spiro Kondën, për të ardhur deri në ditët tona, ku ata që e besojnë këtë ide janë shtuar shumë. Më interesant është, kur te Platoni gjejmë polemikën që bën Sokrati me Ermogjenin, Kratilon dhe vetë Platonin për çështjet e gjuhës dhe të historisë. Sokrati ankohet se "emrat e heronjve të vjetër janë ndryshuar në gjuhën e re (gr. e vjetër. shënimi im) aq sa ata nuk ngjajnë me emrat e tyre të vërtetë". Megjithëse Platoni i thotë se "ka ende njerëz që i njohin me emrat e tyre të vjetër", Sokrati i përgjigjet se "ata sa vinë e pakësohen". Nga ky dialog i tyre, te vepra "Kratilos" e Platonit (395 para Kr.), i bie të kuptojmë se një pjesë e emrave të heronjve grekë të lashtësisë, në mos të gjithë, janë të plagjiatuar qysh në antikitet. Në diskutimet rreth gjuhës, Sokrati është i dëshpëruar pasi, siç thotë ai: "nga alfabeti i vjetër janë hequr shumë tinguj që nuk janë në alfabetin e sotëm. Shumë tinguj janë zvendësuar me të tjerë që janë më të ëmbël për veshin dhe shumë fjalë janë kthyer sëprapi apo gjysëm sëprapi. Gjuha e vjetër është ndryshuar aq shumë sa nuk ngjan me këtë që kemi sot".

Me fjalë të sotme, ligjërata e Sokratit për gjuhën, do kuptohej si: "nga alfabeti i vjetër me shumë tinguj (gërma), për të krijuar greqishten e vjetër (greqishten e re në kohën e Sokratit), janë hequr shumë shkronja që nuk i ka gr. e vjetër. Shumë tinguj janë zvendësuar me të tjerë që janë më të ëmbël për veshin (kjo d.m.th. se janë aplikuar rotacionet për të krijuar fjalë të reja mbështetur në gjuhën paragreke, apo të vjetër, siç e përcakton Sokrati). Shumë fjalë janë anagramuar dhe

të tjera kanë pësuar metatezë = (shumë fjalë janë kthyer sëprapi apo gjysëm sëprapi). Gjuha e vjetër është ndryshuar aq shumë, sa nuk ngjan me këtë që kemi sot". Me fjalinë e fundit Sokrati kërkon të thotë se në shekullin e V - IV, kur ai jetoi, dihej se gjuha e Athinës ishte vepër e ndryshimit të gjuhës së vjetër me anë të ca rregullave që sot i njohim si anagrama, metateza, afereza, epenteza, metafonienta, rotacione etj.

Por cila dhe si duhet të ketë qenë "gjuha e vjetër" për të cilën bën fjalë Sokrati!? A nuk bënte pjesë Athina në Gadishullin Ilirik!? Po. Nëse do hidhnim "hipotezën e çmendur" se greqishtja është bijë e shqipes dhe "gjuha e vjetër" për të cilën flet Sokrati është po shqipja, do na duhej që të vërtetonim me metodën e inversit gjuhësor, duke iu përmbajtur në mënyrën më rigorozë rregullave gjuhësore të njohura nga gjithë gjuhësia e sotme zyrtare, për ta kthyer fjalën greke në origjinën e saj shqipe siç pretendojmë se mundemi dhe e kam bërë në këtë libër. Në këtë vepër risillen një pjesë e vogël e fjalëve të motivuara në dy librat "Gjuha kozmike 1" dhe "Gjuha kozmike 2".

Le të shohim se vetëm përkëmbimi i fonemave qiellzore l:r u jep kuptim dhe etimologji një morie fjalësh të greqishtes: PLANODHlos => pran-udhës (tregëtar që shet pranë udhës); PLEKS => preks = prekz = prek +zë (pleks = thur, por thurja, pleksja bëhet me të prek-ur); PLANITIS (planet) => pran'at (trupat qiellorë që rrotullohen përgjithmonë rreth diellit quhen PRAN-ATit dhe PRAN-AT dha PLAN-AT, PLANET); KLIROS (kler) => kleri (ortodoks) = krer, krerët e ortodoksisë; DILEMË => mëdyshje = më dy sheh (sheh dy mundësi dhe nuk vendos), por sheh = vëre = vë RE dhe DILEMË = DYLEME = DYREME = DY RE ME = ME RE DY = ME vREjt DY; FRASIS (frazë) => FRAS(is) => FLAS, me fol; NEKROS (i vdekur) => NEKLOS = NUKLOS = NUK LOS dhe gjërat e vdekura nuk-los(in) = nuk lozin; etj.

Etimologjia e greqishtes nuk mund të bëhet pa shqipen pasi ajo (greqishtja) u krijua nga shqipja. Kështu, fjala PTOMA (trup pa jetë, kufomë) e greqishtes me rotacionin p:f (si te pthos : fthos, apo fsheh : psheh), na jep: PTOMA = FTOMA = FTO MA = i FTOh MA = ma i ftoht se trupat e gjallë. Kur dikush vdes, trupi i tij është MA i FTOH = i FTOh MA => FTO'MA = PTOMA. Etimologjia që paraqesim në këtë libër mbështetet e gjitha në teorinë e embriomorfeve, e cila nuk mund të krahasohet si metodikë me etimologjinë krahasuese. Përfundimet që dalin nga etimologjia e embriomorfemave në shumicën e rasteve janë krejt ndryshe nga etimologjia krahasuese dhe konkretisht edhe nga etimologjia zyrtare greke e përfaqësuar nga Babinjoti të cilit i jemi referuar shumë shpesh në këtë vepër. Për të dhënë një shembull tjetër se si operon etimologjia e embriomorfeve, po japim etimologjinë e fjalës PNEVMONE, që në shqip ka kuptimin MUSHKRI. Si fillim, motivojmë fjalën shqipe. Në bazë të parimit të funksionalitetit, mushkria ka dy funksione: 1. të mbushet me ajër dhe 2. të nxjerrë ajrin. E bërë si ekuacion i dy funksioneve, kemi: 1 + 2 = MUSH + KRI dhe në gënisht MUSH = MBUSH dhe KRI, në të folmen e Gjirokastrës ka kuptimin nxjerr (t'i krej sytë = t'i nxjerr sytë; krej peshkun nga uji = nxjerr peshkun nga uji). Atëherë vijmë tek fjala PNEVMONE, e cila duhet të jetë emërtuar sipas parimit të funksionalitetit. Por, që të gjejmë të vërtetën e fjalës greke duhet të marrim parasysh, përveç parimit të funksionalitetit edhe rotacionet që ka pësuar fjala në origjinë për të ardhur në trajtën e konservuar që e gjejmë sot. Dihet se rotacioni **P: F** ndodh si te fjalët shqipe psheh: fsheh ose greqisht **p**thos: **f**thos. Rotacioni tjetër është po ai i njohuri **B: V** si te **b**arka: **v**arka dhe në fund

kemi rotacizmin **N: R** si te blini : bliri, ose rëra : rana. Atëhere, duke bërë këto rotacizma të njohura tek fjala PNEVMONE marrim: PNEVMONE

↓ ↓ ↓ ↓

rotacizmat: **FREBMORE**

FRE+B+MORE =

B+FRE+MORE =

B+FRY+MORE = Bën FRYm MARRJE, ku fryn ka edhe kuptimin nxjerr, ikën dhe MARRje ka kuptimin merr, mbushet. Pra, arritëm në të njëjtin përfundim si te fjala MUSHKRI, që edhe ajo ka dy funksione.

Le të japim edhe një nga fjalët më të diskutuara greke, që është fjala HIMONas, tek e cila dallojmë temën HIMON. Për të kuptuar etimologjinë e kësaj fjale, duhet të shpjegojmë fjalën shqipe DIMËR, e cila e ndarë në dy rrokje jep DI + MËR dhe me metatezë rrokjesh marrim MËR + DI = MËRDI + MËRDHI. Tek fjala shqipe DIMËR e shkruar sipas funksionalitetit MËRDHI (me mardh, ftohtë) që në këtë rast tregon karakteristikën kryesore të stinës së dimrit në të cilën njeriu MËRDHI. Pra, fjala DIMËR e shkruar me DH jep DHIMËR e kësaj të fundit, duke i hequr me aferezë shkronjën e parë marrim: DHIMËR - D = HIMËR = HIMËN = HIMON.

Në hapësirën filologjike greke vlen të përmendim dy personalitete të spikatur të albanologjisë që me kast janë lënë jashtë vëmendjes së institucioneve zyrtare të albanologjisë në shtetin shqiptar. Bëhet fjalë për Panajot Kupitorin (1821 - 1881) dhe Jakov Thomopulo. I pari (Kupitori) shquhet për veprën "Studime shqiptare - Të vërteta historike e filologjike rreth gjuhës dhe etnosit shqiptar". Historiani i sotëm grek Sarandos Kargakos në librin e tij "Shqiptarët - arvanitët - grekët" (bot. I. Sidheris Athinë 2001 fq. 103), shkruan kështu: "Kupitori beson se shqipja është më e vjetër se pellazgishtja dhe se gjuha grekoitalike ose lastari i parë i grekoitalishtes dhe përpara degës grekolate; motra e madhe e greqishtes dhe e latinishtes; e njëjtë me to edhe si formë edhe si ndërtim, e bashkërrënjshme dhe e të njëjtit degëzim. Shqiptarët janë pellazgët e vjetër ose degëzimi greko-italik që u shkëput nga trugu më herët se sa të ndaheshin grekët dhe romakët". Kupitori arrin në përfundimin se "Pellazgët janë vëllezërit e mëdhenj të grekëve dhe latinëve dhe se shqiptarët janë pellazgë dhe gjuha e tyre është pellazgishtja" (Kupitori, Studime... f. 53).

Edhe me shumë interes është vepra në dy vëllime e Jakov Thomopulos "Ta pelazgjika" (1911), që është një fjalor trigjuhësh (pellazgisht, shqip, greqisht), ku duket qartë se pellazgishtja dhe shqipja janë pothuaj e njëjta gjuhë. Edhe për veprën aq të çmuar të këtij autori, albanologjia zyrtare hesht në mënyrë të organizuar! Porse kjo heshtje dikur duhet ndërprerë dhe të respektohen vlerat e këtyre albanologëve. Vlen të përmendim se Sarandos kargakos në librin e tij "Shqiptarët - arvanitët - grekët" f.130 thekson se "Siç dendur kam shkruar, gjuha greke është veçanërisht e vështirë, dhe kërkon funksionimin e shkollës që të mbruhet, . Në të kundërt, gjuha shqipe ishte më shumë gjuhë përdorimi, pa shumë kërkesa gramatike, me fjalor të përcaktuar dhe prandaj munda të mbijetonte".

Historia zyrtare e marrdhënieve gjuhësore shqiptaro greke ka një linjë të egër lufte të greqishtes ndaj shqipes për ti rrëmbyer kësaj të fundit territorin gjuhësor. Kisha greke e ka nisur e para

betejën ndaj shqipes më herët se Greqia të bëhej shtet i pavarur më së shumti nga kontributi dhe gjaku i derdhur nga shqiptarët dhe arvanitët. Le ti referohemi sërish librit të S. Kargakos "shqiptarët, arvanitët, grekët" f. 241, ku shkruan: "Është e qartë se, nëse nuk do ishte shën Kozma Etoli, i cili me predikimet e tij, forcoi elenizmin në ndërgjegjen e njerëzve të thjeshtë, shqiptarizimi në zonat veriperëndimore do ishte përmbyllur". Ndërkaq, nuk njihet ndonjë përpjekje e dokumentuar për shqiptarizimin e Epirit, të cilin, për hir të së vërtetës, në hartat zyrtare greke të para vitit 1912 e gjejmë të emërtuar si KATO ALVANIA (Shqipëria e Poshtme). Në epokën e shën Kozmait (gjysma e dytë e shek XVIII) nuk bëhej fjalë për shkolla shqipe e ksisoj dhe për përhapjen me shkrim të shqipes as brenda popullsisë shqiptare e jo më në etnitë e tjera me të cilët shqiptarët ishin gjitonë.

Po në atë faqe të librit të tij, Kargakos perifrazon Apostolos Vakalopoulos, (autorin e librit "Historia e Neohelenizmit" vol.D, f. 439), i cili ka shkruar për Kozma Etolin: "Për të përhapur greqishten në vendet vllahishtfolëse e shqipfolëse, kërkoi nga banorët e Epirit të ndërtojnë shkolla dhe mos të të flasin midis tyre përveçse greqisht. Dhe si këmbim u premtonte se do merrte përsipër gjith mëkatet e tyre". Më poshtë Kargakos shkruan: "'me fjalë të tjera shenjtori u thoshte: "flisni greqisht dhe gjynahet tuaja do ti shpaguej unë"'!! Qartazi, këto dëshmi të shkruara nga vetë historianët grekë edhe të sotëm, na tregojnë hapur se kisha greke ka punuar me të gjitha mënyrat për të asimiluar popullsinë shqiptare, edhe duke i mashtuar me anë besimit. Se si mund të gënjejë besimtarët e një etnie tjetër një "shenjtor" dhe një religjion për të shkombtarizuar një tjetër etni, kjo është temë për historianët.

Më tej mund të themi se, kur u hap shkolla e parë shqipe në Korçë (1878), në Shqipërinë me më pak se një milionë banorë kishte 3000 shkolla ku 1300 ishin greke dhe gati po kaq turke e të tjerat bullgare, serbe e vllahe. Aq shumë shkolla të huaja për shqiptarët tregojnë se asimilimi i shqiptarëve synohej nëpërmjet shuarjes së gjuhës shqipe. Histeria ndaj shqipes ishte më e madhe brenda Greqisë së pas revolucionit grek ku është përdorur dhe dhunë fizike. Ende dhe sot ka shqipfolës të vjetër në Greqi që dëshmojnë se kur ishin nxënës në klasë të parë fillore, për çdo fjalë shqip që flisnin në klasë, si dënim mësuesi i qëllonte me një shufër 20 herë në pëllëmbën e njërës dorë dhe po aq në dorën tjetër. Linja stoike greke kundër shqipes vazhdon dhe në kohën tonë, ku pamvarsisht se Greqia është antare e BE-së dhe ka detyrime që burojnë nga marrveshjet e konventat e BE-së për të lejuar që të futet mësimi i gjuhës disa orë në javë së etnive që përbëjnë mbi 20% të nxënësve, kjo nuk ndodh. Dhe kjo nuk lejohet jo vetëm për fëmijët e emigrantëve shqiptarë, por as edhe për arvanitasit.

Metodologjia dhe etimologjia që sjell në këtë vepër nuk ka asnjë të panjohur për studjuesit e gjuhës, përveç risisë se operohet me embriomorfet e shqipes, të cilat ekzistojnë dhe nuk mund të refuzojë dot askush prezencën e tyre të lirë në gjuhën shqipe. Ngërçi, është se këto embriomorfema janë prezente në fjalëformimin e të gjitha gjuhëve i.e. dhe kanë kuptim vetëm në shqip, përndryshe, nëse ato do kishin kuptim të gjitha në një gjuhë tjetër si anglisht apo gjermanisht etj. misteri i prejardhjes së fjalëve do që zgjidhur shumë kohë më parë. Por, ja që etimologjia e vërtetë shkencore është peng i gjuhës shqipe mu për faktin se vetëm ajo posedon tabelën e embriomorfemave dhe se gjuhëtarët e saj "të shquar" nuk kanë patur syzet e duhura për të bërë të duhurën në fushën e etimologjisë.

Skepticizmi se shqipja nuk mund të ishte qendra e gjuhëve i.e. nuk mund të ishte justifikim për gjuhëtarë si Çabej, Demiraj, Topalli etj., të cilët u treguan armiqësorë ndaj prurjeve befasuese për shqipen nga Manjani, Konda, Zheji etj., që provonin se shqipja kishte impakt në krijimin e shumë gjuhëve të tjera. Nga ana tjetër botohej, lëvdohej, trumpetohej dhe mbështetej çdo vepër etimologjike që e përcaktonte shqipen si gjuhë të huazuar në masën më të madhe të leksikut të saj dhe kjo e vulosur "shkencërisht" nga ASH e Tiranës.

Është faktuar, se nga një anë Çabej botonte veprën e vetë shkombëtarizuese (pa recensë dhe oponencë shkencore) "studime etimologjike në fushë të shqipes" dhe nga ana tjetër anatemonin e pengonin së bashku me Aleks Budën çdo njeri që sillte prurje në dobi të shqipes. I shkruaj e i rishkruaj ca gjëra në lidhje me Çabejin, pasi ai respektohet si autoriteti më i madh në gjuhësinë shqiptare dhe cdo kush që i referohet atij për çështjet e etimologjisë ka bindjen se ai është i padiskutueshëm në ato çka shkruar. Por, ja që Çabeji nuk ka kaluar në filtrin e oponencës shkencore për etimologjinë e tij. E pompuan si personalitet shkencor, e pranuan si të tillë, e mitizuan, e bronxëzuan dhe nuk arritën të shohin kurrë se ai shkombtarizon gati fjalë për fjalë gjithë fondin leksikor të shqipes.

Në këtë parathënie për etimologjinë e greqishtes nuk do mund ta kurseja Çabejin sepse, me një të rënë të lapsit, ai gjithë fjalët e njëjta që kanë greqishtja e shqipja, i quan greke. Duket, se për të qenë brenda dhe i pranuar, ka zbatuar parimin e inferioritetit dhe ka falur gjithshka (fjalë) që ngjanin në gjuhë të tjera si të huaja, paçka se gjuhëtarë të atyre gjuhëve i përcaktojnë si autentike shqipe. Rasti është se gjuhëtari më i shquar grek, Babinjioti, në librin e tij "etimologjiko leksiko tis neas elenikis glosas" bot. 2011, fjalët e greqishtes: kallamboq, kukurec, kullandris, llucë, merimangë, plaçkë, zverk, cigun, çupë etj., që i vendos si huazime të sigurta nga shqipja, Çabeji dhe kopjaci i tij, Topalli, i pagëzojnë si fjalë greke e serbe!!

Shkombtarëzimi i gjuhës shqipe nga akademikët zyrtarë të gjuhës shqipe ngjan me një strategji të menduar mirë. Përfundimi më i hidhur ishte "fjalori etimologjik i gjuhës shqipe" (2017) me autor K. Topallin i cili e nxjerr shqipen me leksik 93% të huazuar. Ky fjalor u nderua me çmim të parë nga ASH Tiranë më 2018. Ato 7%, që Topalli ia lë gjuhës shqipe si të sajat, nuk është se iu dhimbs gjuha shqipe se mos mbetej krejt pa fjalë, thjesht ai 7% fjalësh i shqipes nuk ngjajnë më asnjë gjuhë tjetër, që ai t'i falte përkatësisht. "Mjafton që një fjalë e shqipes të ngjajë paksa nga forma me një fjalë të huaj dhe fjala nuk është shqip" dhe ky është parimi kryesor i Çabejit dhe Topallit për të përcaktuar etnicitetin etimologjik të fjalës.

2. PËRFUNDIME

1. Dinjiteti i një gjuhe përcakton edhe dinjitetin etnik e kombëtar të atij populli që flet atë gjuhë.
2. Nxjerrja e shqipes zyrtarisht si 93% me fjalor të huazuar e ka një qëllim final: t'i tregojë botës se vetë shqiptarët pranojnë zyrtarisht se nuk kanë identitet gjuhësor dhe gjuha që flasin është një mballomë gjuhësh të huaja.

3. Ndaj, Akademia e Studimeve Albanologjike, ku u gatuan fjalori i Topallit si dhe Instituti i Gjuhësisë brenda kësaj akademie së bashku me ASH-në të Tiranës kanë një strategji të përbashkët proslave dhe justifikohet kështu heshtja ndaj vlerave si: Manjani, Katapano, Konda, Zheji, Kola, Stilos etj.
4. Nuk pres që edhe ky libër i imi për greqishten të pritet me dashamirësi nga këto institucione. Porse jeta ka vërtetuar se shkenca nuk mund të ndalet sado barriera t'i venë përpara.

3. STUDIME MBËSHTETËSE

